



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ prot

Gramsh, më ____ / ____ /2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Data: 30.05.2024]

Drejtuar: “RESTAURIM GURRA-KACA”sh.p.k, **Nipt** K 87706601 M, **Adresa:** Elbasan Librazhd LIBRAZHD Zona Industriale, Ish Ndermarja e Ndertimit, zona kadastrale 2446, numri pasurise 1/564.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-01899-04-18-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Merimetim kanali dhe tub çeliku, sifoni në degëzimin Bërsnik- Mashan në Nj. A. Kodovjat" Bashkia Gramsh, Fondi limit : 4,750,001.649 (katër milion e shtatëqindë e pesëdhjetë mijë e një pike 649) lekë pa TVSH, Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 48 ditë

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): JO

Buletini i Njoftimeve Publike [Data:22.04.2024] [Numri:20]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **OE** -“RESTAURIM GURRA-KACA”sh.p.k - **Nipt** - K 87706601 M - **Vlera-** 4,494,026 (katërmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e katërmijë e njëzetë e gjashtë) lekë,pa TVSH
2. **BOE** - “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k - **Nipt** - L 41513008 A & “ISOBAR CONSTRUCTION” sh.p.k - **Nipt** - L 12210036 D - **Vlera-** 4,414,638.45 (katërmilionë e katërqind e katërmbydhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë pikë 45) lekë,pa TVSH
3. **OE** -“ASI INVEST”sh.p.k - **Nipt** - M 01927023 H - **Vlera** - 3,299,625 (tre milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë) lekë,pa TVSH
4. **OE** -“AVDULI”sh.p.k - **Nipt** - J 66703306 O - **Vlera-** 3,795,383 (tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë,pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE - “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k - Nipt - L 41513008 A & “ISOBAR CONSTRUCTION” sh.p.k - Nipt - L 12210036 D

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky BOE nuk përmbush të gjithë kriteret lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Pergjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të përkohshëm në DST dhe në legjislacionin në fuqi, konkretisht;

Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika **2.3.1 “Përvojë të suksesshme”... ndër të tjera është kërkuar :**

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 1. **Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:**
 2. Kontraten/at e Sipermarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
 6. Faturat tatimore të prera për objektin;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme anëtarit “Apis Construction” shpk ka dorëzuar kontratën nr.1073/1 datë 19.05.2023 me bashkinë Selenicë me objekt “Rehabilitim pastrim mirëmbajtje kanale vaditëse 2023”, **por nuk është dorëzuar Formulari i vlerësimit për realizimin e punimeve Shtojca 9.** Gjithashtu situacionet përfundimtare të dorëzuar për këtë objekt në SPE janë fotokopje në kundërshtim me kriteret e kualifikimit në të cilat kërkohej që **“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara”.**

Edhe anëtarit tjetër i BOE **“ISOBAR Construction “ shpk**, për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme ka dorëzuar në SPE Akt marrëveshje (Kontratë nënkontraktimi) me subjektin “Viantë Konstruksion “ shpk i cili ka lidhur kontratë me bashkinë Cërrik si pjesë e BOE “Viantë Konstruksion “ shpk & “Fusha “shpk & Euroalb” shpk, me objekt “Nderim ujesjellesi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas, Bashkia Cërrik”, por **nuk është shoqëruar me Formularin e vlerësimit të punimeve** sipas Shtojcës 9 ku të jenë përcaktuar anëtarët e BOE, % e pjesëmarrjes në bashkim, nënkontraktorët, vlera dhe përkrahimi i punëve të kryera nga anëtarët e BOE dhe nënkontraktorët, gjithashtu në dokumentat bashkëngjitur në SPE në asnjë dokument të bashkisë Cërrik si akt kolaudimi, akti i marrjes në dorëzim, nuk figuron emri i nënkontraktorit “ISOBAR Construction“ shpk, si dhe nuk është dorëzuar kontrata bazë e lidhur mes BOE “Viantë Konstruksion “ shpk & “Fusha “shpk & Euroalb” shpk dhe bashkisë Cërrik, dhe në asnjë dokument nuk provohet përqindja e punimeve të marra përsipër nga anëtarit i BOE “Viantë Konstruksion “ shpk, punimet e të cilit ia ka deleguar me nënkontratim anëtarit pjesëmarrës në procedurën aktuale për vlerësim “ISOBAR Construction “ shpk.

Në kriteret e kualifikimit është përcaktuar gjithashtu se për kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në SPE nuk është dorëzuar asnjë nga dy dokumentet e sipërpërmenduar.

Sa më sipër, BOE "Apis Construction" shpk & "ISOBAR Construction" shpk nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme në kundërshtim me nenin 39/5 të VKM –së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe me kërkesat e vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

- Në kriteret e kualifikimit në pikën 2.3.7 janë kërkuar 10 tabela të sigurimit teknik, nga anëtari "Apis Construction" shpk në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit nuk është deklaruar asnjë tabelë, ndërsa anëtari tjetër "ISOBAR Construction" shpk ka deklaruar 3 fatura tatimore por nuk është deklaruar numri i tabelave të sigurimit teknik, për këtë arsye ky kriter konsiderohet i papërmbushur.
- Në kontratën e bashkëpunimit lidhur mes dy anëtarëve të bashkimit, operatori ekonomik "Apis Construction" shpk ka marrë përsipër të kryejë 20 % të punimeve dhe anëtari tjetër "ISOBAR Construction" shpk ka marrë përsipër të kryejë 80 % të punimeve. Referuar shtojcës nr.2 'Lista e cmimeve sipas zërave të preventivit' rezulton se preventivi është në vlerën 4 414 638.45 lekë pa TVSH. Sipas përqindjes së marrë përsipër anëtari "Apis Construction" shpk i takon të kryejë $4\,414\,638.45 \times 20\% = 882\,927.69$ lekë pa TVSH të punimeve, ndërsa në preventivin e ndarjes së punimeve ka deklaruar 891 389,59 lekë, pa TVSH, që do të thotë 8 461.9 lekë më shumë se preventivi i ofertës. Po kështu anëtari "ISOBAR Construction" shpk i takon të kryejë $4\,414\,638.45 \times 80\% = 3\,531\,710.76$ lekë pa TVSH ndërsa në preventivin e ndarjes së punimeve ka deklaruar 3 523 248 .86 lekë, pa TVSH, që do të thotë 8 461.9 lekë më pak se preventivi i ofertës.
- Në pikën 2.2.2 të kriterëve të kualifikimit është kërkuar "Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Anëtari "Apis Construction" shpk, nuk ka dorëzuar bilancet e viteve 2020-2021, po kështu bilanci i vitit 2022 nuk rezulton të jetë i konfirmuar nga administrata tatimore

2. OE –"ASI INVEST"sh.p.k - Nipt - M 01927023 H

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky OE nuk përmbush të gjithë kriteret lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkuara në DST dhe në legjislacionin në fuqi, konkretisht;

- Në shtojcën 2 "Lista e cmimeve sipas zërave të preventivit" operatori ekonomik ka ndryshuar sasinë e zërave të punimeve, konkretisht: zëri "Struktura monolit beton C-16/20 (bazamente, breza)", sasinë e planifikuar nga Autoriteti Kontraktor janë 4.2 m³, OE ka shënuar 4 m³, zëri F.V.Hekur betoni I zakonshëm mbi Ø 12, sasinë e planifikuar nga Autoriteti Kontraktor janë 0.08 ton, OE ka shënuar 0 ton, zëri F.V.konstruksione thjeshta metalik detale në beton, sasinë e planifikuar nga Autoriteti Kontraktor janë 0.09 ton, OE ka shënuar 0 ton.
- Operatori ekonomik në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar një kamion mbi 7.5 ton si dhe një kamion me vinc mbi 10 ton në pronësi ose me qira,

ka deklaruar vetëm një kamion me targa AA610 ST pa përcaktuar çfarë kamioni është dhe pa përcaktuar kapacitetin mbajtës. Kështu që nuk përmbush kriterin për një kamion mbi 7.5 ton si dhe një kamion me vnc mbi 10 ton në pronësi ose me qira.

- Operatori ekonomik tek tabela për disponimin e mjeteve nuk ka përcaktuar targën, nr.e lejes së qarkullimit si dhe nr.e shasisë për mjetin autobetoniere kantieri si dhe nr . e shasisë për eskavator me zinxhir.

3. OE –“AVDULI”sh.p.k - Nipt - J 66703306 O

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky OE nuk përmbush të gjithë kriteret lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kerkuar në Kriteret e Pergjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkruara në DST dhe në legjislacionin në fuqi, konkretisht;

- Ofertuesi “Avduli” shpk ka nënshkruar me Autoritetin Kontraktor Bashkia Gramsh kontratën e sipërmarrjes nr.4956 prot datë 15.12.2023 me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” me afat 22 ditë. Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë më datë 15.12.2023 me afat përfundimi më datë 05.01.2024. Autoriteti Kontraktor ka konstatuar se operatori ekonomik “Avduli” shpk deri sot në datën e vlerësimit të kësaj procedure punimet në objektin e mësipërm nuk kanë përfunduar, nuk ka asnjë njoftim me shkrim nga ana e shoqërisë “Avduli” shpk për shtyrje afati punimesh dhe arsyet që mund të kenë cuar në zgjatjen e tyre. Nga 12 objektet e parashikuara në kontratë për rikonstrosion banesash për komunitetet be varfëra dhe të pafavorizuara kanë përfunduar vetëm 8(tetë) prej tyre dhe të papërfunduar 4(katër) prej tyre. Legjislacioni për prokurimet publike parashikon se Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i plotë kontratës si dhe gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuara me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi. Strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit për mbikëqyrjen e kontratës, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Për objektin “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” struktura e ngarkuar me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor ka konstatuar se kontraktori “Avduli” shpk është në vonesë në tejkalim të afatit prej më tepër se 4 muaj , në shkelje të plotë të kushteve të kontratës dhe të legjislacionit që mbulon fushën e prokurimeve publike.
- Kamioni me kapacitet mbajtës mbi 7.5 ton me targë AA691HY i deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të procedurës objekt vlerësimi është i deklaruar edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të kontratës së papërfunduar më sipër me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
- Kokore/helmeta mbrojtëse 12 copë, Tabela Sigurimi Teknik 10 copë, Kutitë ndihme e shpejtë 5 copë të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të procedurës objekt vlerësimi janë të deklaruara me të njëjta numër faturash tatimore edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të kontratës së papërfunduar më sipër me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE** -“RESTAURIM GURRA-KACA”sh.p.k - **Nipt** - K 87706601 M se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **Vlera- 4,494,026** (katërmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e katërmijë e njëzetë e gjashtë) lekë,pa TVSH , pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *AK-së Bashkia Gramsh*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

**ZYRTARI I AUTORIZUAR
N/KRYETARI I BASHKISË**
Tajar BICI

Konceptoi: E.Shahini

Pranoi: E.Shahini

Miratoi:

Konfirmoi:

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____